




**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO



**KËSHILLI PROKURORIAL I KOSOVËS**  
TUŽILAČKI SAVET KOSOVA - KOSOVO PROSECUTORIAL COUNCIL

**BULETINI I KËSHILLIT  
PROKURORIAL TË  
KOSOVËS 2024**



*Prishtinë, 2024*

# AKTIVITETET E KËSHILLIT PROKURORIAL TË KOSOVËS

(Në këtë edicionin pasqyrohen aktivitetet e KPK-  
së për muajin dhjetor të vitit 2024)

## Përfaqësuesit e sistemit prokurorial vizitojnë institucionet e drejtësisë turke

Prishtinë, 2 dhjetor 2024 - Në kuadër të vizitës zyrtare në institucionet e drejtësisë të Republikës së Turqisë, Kryesuesi I Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj dhe Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, të shoqëruar nga Zëvendëskryesuesja znj. Jehona Grantolli dhe anëtarë të KPK-së, Drejtori i Përgjithshëm i Sekretariatit të KPK-së dhe ai i NJSHPP-së, si dhe zyrtarë të administratës së sistemit prokurorial, filluan sot takimet me zyrtarë të lartë të Akademisë së Drejtësisë, si dhe do të vijojnë me ato në Këshillin Gjyqësor, Këshillin Prokurorial të Turqisë dhe Gjykatën Kushtetuese të Turqisë.

Me këtë rast, Kryesuesi Hajdaraj, në fjalën e tij përshëndetëse, tha se diskutimet dhe interesimi ynë do të përqendrohet tek njohja nga afër e operimit të Akademisë së Drejtësisë dhe edukimit ligjor që zhvillon për prokurorët, marrjen e informacioneve bazike që ndërlidhen me teknikat dhe metodat e punës së këshillave, vlerësimit të performancës dhe disiplinimit, por edhe për praktikave menaxheriale administrative, të cilat si tërësi përbëjnë mbështetjen për mekanizmat përkatës, transparencën dhe llogaridhënia e përgjithshme.



Gjithashtu edhe U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Kelmendi, nënvizoi rëndësinë e fuqizimit të bashkëpunimit dypalësh me Qeverinë turke, me fokus të veçantë në çështjet që kanë të bëjnë me hetimin dhe ndjekjen efikase të kryesve të veprave penale specifike, përfshirë korrupsionin publik, konfiskimin dhe sekuestrimin e pasurisë, bashkëpunimin në fushën e ofrimit të ndihmës juridike ndërkombëtare dhe luftimit e terrorizmit.



Vizita e përfaqësuesve të sistemit prokurorial në institucionet e drejtësisë turke realizohet me mbështetjen e Ambasadës së Turqisë në Kosovë, kurse gjatë aktiviteteve të sotme dhe atyre që parashihet të zhvillohen gjatë kësaj vizite, do të ketë diskutime për ngritjen e bashkëpunimit dypalësh në sektorët me interes të përbashkët dhe do të trajtohen informacionet, perspektiva dhe përvojat nga këndvështrimi i zhvillimit të sistemit të drejtësisë së shtetit turk, nga të cilat mund të përfitohet në rritjen e efektivitetit dhe efikasitetit të punës së Këshillit dhe Prokurorit të Shtetit.



## USAID-i i ofron mbështetje Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 3 dhjetor 2024 – Kryetari i Komisionit për Administrimin e Prokurorive, z. Jetish Maloku, ka pritur sot në takim ekspertin ndërkombëtar, z. Benjamin M. Allen, i cili ka përvojë të gjerë në projekte për sundimin e ligjit dhe zhvillimin ndërkombëtar, si pjesë e projektit të USAID-it.



Gjatë këtij takimi, z. Maloku e ka njoftuar z. Allen me prioritetet dhe sfidat që po përballen sistemi prokurorial, si dhe, të arriturat që janë bërë për avancimin e sundimit të ligjit në Kosovë gjatë viteve të fundit. Ai theksoi përpjekjet e vazhdueshme të KPK-së për përmirësimin e efikasitetit, transparencës dhe forcimin e sistemit prokurorial.

Në këtë takim, palët diskutuan mënyrat e mundshme të bashkëpunimit mes sistemit prokurorial dhe projektit të USAID-it, duke shqyrtuar mundësitë për ofrimin e mbështetjes për zgjidhjen e nevojave që paraqiten nga sistemi, me qëllim përmirësimin e reformave në sektorin e drejtësisë. Ky bashkëpunim pritet të luajë një rol të rëndësishëm për forcimin e kapaciteteve të prokurorive dhe për avancimin e mëtejshëm të sundimit të ligjit në Kosovë.

Ky takim është një hap i rëndësishëm në forcimin e marrëdhënieve dhe përpjekjeve të përbashkëta për përmirësimin e sistemit të drejtësisë në vend.

## Reagim nga Këshilli Prokurorial i Kosovës dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit

Prishtinë, 3 dhjetor 2024 - Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) dhe Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit (ZKPSH) detyrohen që edhe një herë të reagojnë ndaj deklaratave të zyrtarëve të Qeverisë së Kosovës, konkretisht ndaj deklaratës së Kryeministrit të vendit, Albin Kurti, i cili dje nga foltorja e Kuvendit ka hedhur akuza të padrejta në drejtim të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Prokurorit të Shtetit dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës, z. Blerim Isufaj.

Deklaratat e Kryeministrit për raste individuale, duke i interpretuar ato në mënyrën e tij dëshirore, pa i ditur faktet dhe duke e keqinformuar publikun në mënyrë të qëllimshme, lëndojnë ndjenjat e familjarëve të të ndjerëve, përbëjnë ndërhyrje dhe presion të drejtpërdrejtë në punën e Prokurorisë dhe cenojnë rëndë pavarësinë e sistemit të drejtësisë.



Një qasje e tillë e Kryeministrit të Republikës së Kosovës dëmton funksionimin e institucioneve demokratike dhe ka për qëllim minimin e reputacionit të Prokurorit të Shtetit në përpjekjet institucionale për forcimin e sundimit të ligjit në Republikën e Kosovës dhe në vend që Kryeministri t'i mbështesë kërkesat buxhetore të sistemit prokurorial, ai zgjedhë rrugën e sulmeve ndaj institucioneve të Prokurorit të Shtetit.

Andaj, KPK dhe ZKPSH i bëjnë thirrje Kryeministrit të vendit, anëtarëve të tjerë të kabinetit qeveritar dhe deputetëve të partisë në pushtet që të jenë të përmbajtur, të tregojnë sjellje të përgjegjshme institucionale dhe të mos tentojnë që përmes diskursit dhe retorikës politike ta sulmojnë sistemin prokurorial.

## Përfaqësuesit e sistemit prokurorial vizitojnë Këshillin Gjyqësor dhe Prokurorial në Turqi

Prishtinë, 3 dhjetor 2024 - Përfaqësuesit e sistemit prokurorial që janë duke qëndruar për një vizitë zyrtare në institucionet turke të drejtësisë, të udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, së bashku me Ushtruesin e Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, vizituan sot Këshillin Prokurorial dhe Gjyqësor të Turqisë, ku janë pritur nga Kryetari i Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor të Turqisë, z. Mehmet Akif Ekinci.



Gjatë takimit, Kryesuesi i Këshillit Prokurorial dhe Gjyqësor të Turqisë, z. Ekinci, falënderoi delegacionin kosovar për vizitën e tyre dhe prezantoi aktivitetet kryesore të veprimtarisë së institucioneve që përfaqëson.

Nga ana tjetër, z. Hajdaraj falënderoi z. Ekinci për pritjen e ngrohtë dhe informacionet e veshme që morën nga ai dhe në emër të Këshillit Prokurorial të Kosovës, shprehu përkushtimin për thellimin e mëtejshëm të bashkëpunimit me sistemin prokurorial dhe gjyqësor të Turqisë.

Ndërsa z. Besim Kelmendi, vuri theksin e tij në bashkëpunimin e ndërsjellë të institucionit të Prokurorit të Shtetit me mekanizmat institucionalë nga Turqia për të shkëmbyer përvojat dhe praktikat më të mira, që ndikojnë në sundimin e ligjit në Kosovë.



Vizita e përfaqësuesve të sistemit prokurorial në institucionet e drejtësisë turke do të vazhdojë edhe gjatë ditës së nesërme, me ç’rast pas Gjykatës Kushtetues të Republikës së Turqisë do të zhvillojnë një takim me Kryeprokurorin e Përgjithshëm në Ankara.





## Vazhdojnë takimet e përfaqësuesve të sistemit prokurorial në Turqi, sot vizituan Gjykatën Kushtetuese

Prishtinë, 4 dhjetor 2024 – Në kuadër të vizitës disaditëshe të përfaqësuesve të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe Prokurorit të Shtetit në Turqi, të udhëhequr nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj dhe Ushtruesi I Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, kanë vazhduar takimet e shumta, me ç’rast sot vizituan Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Turqisë, ku u pritën nga Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatës, z. Yılmaz Çınar.

Ata u njoftuan gjatë vizitës nga Sekretari i Përgjithshëm i Gjykatën Kushtetuese turke, z. Çınar, për aktivitetet që zhvillohen në kuadër të procesit intensiv të punës, si dhe falënderoi delegacionin kosovar për vizitën në këtë institucion të lartë turk të drejtësisë.



Kryesuesi Hajdaraj, gjithashtu, falënderoi Sekretarin Çınar për krijimin e mundësisë për të thelluar njohuritë e tyre për praktikat dhe standardet profesionale të institucioneve turke të drejtësisë, siç është edhe kjo e sotmja në Gjykatën Kushtetuese të Turqisë.

Ndërkaq, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z.Kelmendi, theksoi se sot kishin kënaqësinë e veçantë që u njohën për së afërmi me angazhimet konkrete profesionale dhe administrative të kësaj gjykate të lartë turke, ku u informuan për përgjegjësitë dhe funksionalitetin kushtetues në Republikën e Turqisë.

Bashkëbiseduesit u pajtuan për vazhdimin e bashkëpunimit të ndërsjellë ndërmjet vete për të përforcuar rolin dhe zbatimin e misionit universal të sundimit të ligjit në të dyja vendet.



## Delegacioni i sistemit prokurorial pritet në takim nga Kryeprokurori Publik i Gjykatës së Lartë të Apelit, Muhsin Şentürk

Prishtinë, 5 dhjetor 2024 – Gjatë qëndrimit në Ankara, në ditën e fundit të vizitës zyrtare në Republikën e Turqisë, delegacioni i sistemit prokurorial, i udhëhequr nga U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi dhe i shoqëruar nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj dhe Zëvendëskryesuesja e KPK-së, znj. Jehona Grantolli, është pritur në takim nga Kryeprokurori Publik i Gjykatës së Lartë të Apelit, Muhsin Şentürk.



Me këtë rast, delegacioni nga vendi ynë është njoftuar nga z. Şentürk për organizimin dhe funksionimin e strukturës organizative të institucionit që ai drejton, me theks të veçantë për aktivitetet që zhvillohen në kuadër të luftës kundër krimeve të ndryshme.

Nga ana tjetër, në emër të institucionit të Prokurorit të Shtetit, U. D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Kelmendi, ka shprehur gatishmërinë për thellimin e bashkëpunimit me këtë institucion turk në çështjet me interes të përbashkët, duke vlerësuar përvojën dhe zbatimin e standardeve dhe praktikave të mira. Gjithashtu, edhe Kryesuesi Ardian Hajdaraj falënderoi Kryeprokurorin Şentürk për ofrimin e informacioneve që ndërliken me proceset e punës së këtij institucioni, të cilat hyjnë në shërbim të avancimit dhe ngritjes së kapaciteteve profesionale të sistemit prokurorial në Republikën e Kosovës.

Vlen të theksohet se të gjithë pjesëmarrësit e delegacionit tonë gjatë vizitës në Turqi janë angazhuar në të gjitha takimet e deritashme duke diskutuar me zyrtarët përgjegjës për format dhe çështjet e ndryshme që kanë të bëjnë me intensifikimin e bashkëpunimit ndërshtetëror në mes të institucioneve turke dhe institucioneve të drejtësisë në Kosovë.



## Kryesuesi Hajdaraj priti në takim përfaqësuesit e ekipit të Bankës Botërore

Prishtinë, 10 dhjetor 2024 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial i Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, ka pritur në takim përfaqësuesit e ekipit të Bankës Botërore, Specialistin e Lartë të Sektorit Publik, z. Klaus Decker dhe Specialistin e Qeverisjes, z. Ermal Vila.

Me këtë rast, Kryesuesi Hajdaraj falënderoi z. Decker dhe z. Vila për vizitën dhe më tej diskutoi për objektivin kryesor të këtij projekti që ka të bëjë me përmirësimin e njohurive të nevojshme për të forcuar bashkëpunimin e politikave të drejtësisë në përputhje me procesin e anëtarësimit në Bashkimin Evropian.



Në kuadër të takimit të sotëm, Kryesuesi Hajdaraj dhe përfaqësuesit e këtij ekipi, diskutuan edhe për objektivat e tjetër lidhur me përfundimin e përgatitjeve për mbledhjen e të dhënave dhe për sigurimin e letrave të mbështetjes nga autoritetet e sistemit prokurorial.

Në përfundim të takimit, bashkëbiseduesit janë pajtuar për zhvillimin e mëtejshëm të bashkëpunimit në fushat e interesit, konkretisht për shkëmbimin e njohurive, për të mbështetur prioritetet reformuese të institucioneve të drejtësisë në Kosovë dhe për të mbajtur takime me donatorët dhe partnerët kryesorë.

Ky ekip i Bankës Botërore është duke qëndruar në vendin tonë për të diskutuar me krerët e institucioneve të drejtësisë për zbatimin e Projektit "EU4: Sundimi i ligjit: Mbështetja e politikave të bazuara në dëshmi për sistemin e drejtësisë në Ballkanin Perëndimor."



## Mbahet punëtori për hartimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2025-2027

Prishtinë, 11 dhjetor 2024 – Rritja e efikasitetit dhe efektivitetit, ruajtja e pavarësisë, paanshmërisë, kompetencës dhe funksionimit të sistemit prokurorial ishin në fokus të punëtorisë dyditore, të organizuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës, përkatësisht nga Grupi Punues për hartimin e Planit strategjik të sistemit prokurorial 2025-2027, që udhëhiqet nga Zëvendëskryesuesja e KPK-së, znj. Jehona Grantolli, me mbështetjen e Ambasadës Amerikane në Prishtinë.



Më këtë rast, gjatë zhvillimit të sesionit të parë të punëtorisë, ka prezantuar ekspertja nga SHBA-ja, znj. Tennille Nance, për rrugën drejt hartimit të Planit strategjik.

Në vijim të kësaj punëtorie, znj. Grantolli, tha se ky plan strategjik ka për qëllim orientimin e qartë dhe mbikëqyrjen sistematike të zbatimit të tij, me qëllim të përmirësimit të transparencës dhe llogaridhënies së sistemit prokurorial. Gjatë fjalës së tij, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, nënvizoi rëndësinë e përcaktimit të objektivave që kanë të bëjnë me rritjen e produktivitetit dhe efikasitetit në trajtimin e rasteve të korrupsionit dhe krimit të organizuar dhe përmirësimin e menaxhimit të rasteve.

Pjesëmarrësit e punëtorisë në sesionet e ditës së dytë diskutuan edhe për identifikimin dhe definimin e objektivave, duke dhënë sugjerime, rekomandime dhe propozime në shërbim të hartimit sa më adekuat të kësaj strategjie.

Të pranishëm në këtë punëtori, krahas anëtarëve të grupit punues, ishin edhe përfaqësues nga Ambasada Amerikane në Prishtinë, Zyrës së Bashkimit Evropian dhe OSBE-ja.





## **Mbahet takimi i përbashkët i Zyrës së Kryeprokurorit të Shtetit dhe Gjykatës Supreme me Këshillin Prokurorial, Këshillin Gjyqësor, kryeprokurorët e prokurorive dhe kryetarët e gjykatave të Republikës së Kosovës**

Prishtinë, 12 dhjetor 2024 – Zyra e Kryeprokurorit të Shtetit dhe Gjykata Supreme e Kosovës kanë mbajtur takim të përbashkët me Këshillin Prokurorial të Kosovës (KPK), Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), kryeprokurorët e prokurorive dhe kryetarët e gjykatave të Republikës së Kosovës.

Në fillim të këtij takimi, U.D. Kryeprokurori i Shtetit, z. Besim Kelmendi, theksoi rëndësinë e takimit, duke pohuar se, “Kemi qenë unik në qëndrimet tona në ruajtjen e pavarësisë së sistemit të drejtësisë, kemi qenë unik në çështjet thelbësore për sistemin prokurorial dhe gjyqësor, dhe ky takim është finalizim i sukseseve tona të përbashkëta. Mirëpo, krahas sukseseve ne jemi të vetëdijshëm për hapat që duhet bërë për të avancuar sistemin e drejtësisë, për të pasur më shumë suksese, më shumë efikasitet, më shumë cilësi në punën tonë si gjyqtarë dhe prokurorë. Andaj, çështja e reformës në drejtësi e cila është adresuar në Komisionin e Venecias, çështja e efikasitetit të punës tonë, politika ndëshkimore, masat që janë duke u zbatuar për sigurimin e të pandehurve në procedurën penale, çështja e menaxhimit të rasteve në mënyrë elektronike do të jetë vetëm fillimi i diskutimeve tona.



“Gjithashtu, dua të theksoj se nuk mund të kemi drejtësi për qytetarët dhe të kemi një gjykim në kohë të arsyeshme deri sa kemi mungesës të numrit të prokurorëve, rrjedhimisht mos aprovimit të kërkesave buxhetore të sistemit prokurorial nga pushteti ekzekutiv dhe legjislativ, dhe kjo është shumë shqetësuese dhe po na paraqet pengesa në punën tonë të përditshme për të pasur efikasitet dhe për të mundur realizimin e të drejtave të qytetarëve për qasje në drejtësi”, u shpreh U.D. Kryeprokurori Kelmendi.

Ndërkaq, Kryetari i Gjykatës Supreme të Kosovës, z. Fejzullah Rexhepi në fjalën e tij të mirëseardhjes theksoi rëndësinë e takimeve të tilla, përmes të cilave mund të diskutohen çështje me rëndësi që lidhen me përmirësimin e sistemit të drejtësisë dhe mundësojnë përcaktimin e hapave të rinj drejt rritjes së efikasitetit, transparencës dhe besimit të qytetarëve në institucionet e drejtësisë. Sipas kreu të Gjykatës Supreme, është e rëndësishme të diskutohet për zbatimin e reformave ligjore të vitit 2025, përfshirë kalimin e pakos së ligjeve në Kuvend, sipas Deklaratës së Përbashkët të Zotimit, të cilat janë thelbësore për avancimin e sistemit të drejtësisë. Pjesë e këtij procesi do të jetë edhe përmirësimi i sistemit SMIL, me fokus në mundësinë e koordinimit dhe komunikimit më të mirë ndërmjet Këshillit Gjyqësor, Këshillit Prokurorial, gjykatave dhe prokurorive.



“Po ashtu, diskutimi mbi Politikën Ndëshkimore është ndër temat më të rëndësishme të këtij takimi. Si një komponent kyç për një sistem drejtësie efikas, kredibil dhe të paanshëm, kjo politikë duhet të bazohet në parimet kushtetuese dhe ligjore. Në këtë drejtim, dy javë më parë, me mbështetjen e Ambasadës Amerikane (OPDAT), Gjykata Supreme lansoi Udhëzuesin për Matjen e Dënimit, një dokument me rëndësi për unifikimin e praktikës gjyqësore dhe rritjen e cilësisë së vendimmarrjes”, u shpreh mes tjerash kreu i Supremes. Ai falënderoi partnerët e pranishëm ndërkombëtarë, për mbështetjen e tyre të çmuar dhe të vazhdueshme përgjatë reformave të shumta në drejtësi.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, vuri theksin në fuqizimin e sistemit të drejtësisë. “Duke pasur parasysh natyrën e punës së Këshillit Prokurorial dhe atij Gjyqësor, të arriturat dhe sfidat me të cilat ballafaqohemi janë te njëjta. Rrugëtimi jonë drejt ruajtjes së pavarësisë së institucioneve, transparencës, llogaridhënies, fuqizimit të dy sistemeve është i përbashkët”, nënvizoi z. Hajdaraj.

Ndërkaq, kryesuesi i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, z. Albert Zogaj duke folur për koordinimin dhe përgatitjen e sistemit gjyqësor dhe sistemit prokurorial për zbatimin e reformës gjatë vitit 2025, potencoi nevojën e koordinimit për pakon e reformës në drejtësi, e cila sipas tij, nuk është ideale por është reale, “përfaqëson punën e përbashkët dhe ka marrë dritën jeshile për të kaluar filtrin e Komisionit të Venecias”. Kryesuesi potencoi se “Kemi arritur në një fazë të rëndësishme të hartimit të kësaj reforme e cila ka kaluar përmes një iniciative të përbashkët”, ndaj, ai falënderoi gjyqtarët, prokurorët e përfshirë në këtë proces, drejtues të institucioneve dhe në mënyrë të veçantë partnerët ndërkombëtar, të cilët e kanë legjitimuar këtë nismë për sistemin e drejtësisë. Kryesuesi Zogaj theksoi rëndësinë që i është kushtuar mbrojtjes së pavarësisë së sistemit gjyqësor dhe atij prokurorial gjatë këtij procesi.

Rreth shtatëdhjetë pjesëmarrës në takim diskutuan për koordinimin e gjykatave dhe prokurorive, produktivitetin e seancave gjyqësore dhe efikasitetin në trajtimin e rasteve; zbatimin e Udhëzuesit të Gjykatës Supreme për Politikë Ndëshkimore, rritjen e cilësisë së hetimit dhe vendim-marrjes si dhe vlerësimin e praktikës në procedurën e masave të sigurimit të të pandehurit në procedurë; avancimin e sistemit për menaxhimin e lëndëve dhe vlerësimin e mundësisë së marrëveshjes në mes KGJK – së dhe KPK – së, që gjykatat dhe prokuroritë të komunikojnë përmes sistemeve elektronike si dhe për mbajtjen e takimeve të rregullta gjatë vitit 2025, në mes të Këshillave dhe në mes të gjykatave dhe prokurorive.

Pjesëmarrësit në takim ranë dakord që të themelohet Grupi Punues në përbërje të: Kryetarit të Gjykatës Supreme, u.d. Kryeprokurorit të Shtetit, Kryesuesit të KGJK-së dhe atij të KPK-së, zëvendës-kryesueseve të KGJK-së dhe KPK-së dhe prej një përfaqësuesi të gjyqësorit dhe një përfaqësuesi të Prokurorisë.

Ky Grup Punues do të caktojë nëngrupet punues dhe do të organizojë takimet e tilla gjithëpërfshirëse.



## Mbahet Takimi i 259-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 12 dhjetor 2024 – Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 259-të me radhë, në të cilin:

1. Miratoi Procesverbalin e Takimit të 258-të të Këshillit Prokurorial të Kosovës dhe
2. Caktoi prokuroren Bedrije Sylja-Alshiqi në pozitën e Ushtrueses së Detyrës të Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit.



## Vazhdon hartimi i draftit të Rregullores për Krijimin dhe Funksonimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit

Prishtinë, 13 dhjetor 2024 – Në kuadër të ngritjes së kapaciteteve hetimore dhe bashkëpunimit ndërsektorial kundër krimit të organizuar dhe krimeve të rënda, Grupi punues i caktuar nga Këshilli Prokurorial i Kosovës për hartimin e draftit të Rregullores për Krijimin dhe Funksonimin e Ekipeve të Përbashkëta të Hetimit, i cili kryesohet nga Zëvendëskryeprokurori i Prokurorisë Speciale, z. Valdet Gashi dhe mbështetet nga Ambasada Britanike në Prishtinë dhe SCSJ Consultant, ka vazhduar hartimin e këtij dokumenti nënligjor.



Krahas anëtarëve të grupit punues ishin pjesëmarrës edhe Zëvendësdrejtori i Policisë së Kosovës, përfaqësues të Njësisë së Inteligjencës Financiare, Doganës së Kosovës, Administratës Tatimore të Kosovës dhe Ambasadës Britanike në Kosovë, të Zyrës së BE-së dhe EULEX-it.

Gjatë sesioneve të sotme të punëtorisë, pjesëmarrësit diskutuan dhe trajtuan çështjet që ndërlidhen me qëllimet dhe parimet esenciale të bashkëpunimit ndërsektorial për hetimin dhe ndjekjen efikase të veprave penale komplekse, të cilat ndikojnë në ngritjen e cilësisë së hetimeve, si dhe në ndërveprimin dhe efektivitetin e mekanizmave të tjerë të sigurisë.

Duke marrë parasysh gjithnjë rëndësinë e rritjes së cilësisë së hetimeve dhe ngritjen e kapaciteteve hetimore, në përmbyllje të punëtorisë, u tha se ky grup do të vazhdojë punën deri në finalizimin e draftit, duke përcaktuar kritere të qarta për organizimin e brendshëm, metodat, bashkëpunimin dhe procedurat e tjera të punës për ekipet e përbashkëta të hetimit.



## Mbahet takimi i Komisionit për Buxhet, Financa dhe Personel

Prishtinë, 20 dhjetor 2024 - Komisioni për Buxhet, Financa dhe Personel i Këshillit Prokurorial të Kosovës, i udhëhequr nga prokurorja Ariana Shajkovci, mbajti takimin e radhës sipas agjendës së paraparë, në të cilin morën pjesë anëtarët e Komisionit, Udhëheqësja e Departamentit për Buxhet dhe Financa dhe U.D. Udhëheqësja e Njësitit për Prokurim.



Në këtë takim është shqyrtuar Plani përfundimtar i prokurimit për vitin 2025, me ç' rast është miratuar nga anëtarët e këtij Komisioni dhe i njëjti do të procedohet në Agjencinë Qendrore për Prokurim.

## Mbahet takimi i fundit për këtë vit i Komisionit për Administrimin e Prokurorive

Prishtinë, 23 dhjetor 2024 – Raporti për trajtimin e rasteve me kryerës të panjohur, analiza e numrit të nevojshëm në Prokurorinë Themelore në Gjakovë dhe diskutimet për Planin e punës për vitin 2025, ishin në fokus të takimit të sotëm të Komisionit për Administrim të Prokurorive, të cilin e kryesoi z. Jetish Maloku, ku morën pjesë edhe anëtarët e këtij komisioni, prokurorja Laura Pula dhe prokurori Admir Shala.

Në pikën e parë është prezantuar drafti i Raportit për trajtimin e rasteve me kryerës të panjohur, raport ky, në të cilin janë inkorporuar konkluzionet dhe rekomandimet e bëra në njërin nga takimet e KPK-së.



Gjithashtu, në pikën e dytë të rendit, është nënvizuar nevoja e hartimit të analizës së plotë vjetore, në të cilën do të përfshihej edhe tremujori i fundit i vitit 2024, për të pasur një pasqyrë më të plotë për numrin e nevojshëm të prokurorëve në Prokurorinë Themelore në Gjakovë.

Në përmbyllje është diskutuar edhe për Planin e punës së Komisionit për Administrimin e Prokurorive për vitin 2025, me ç'rast u theksua se do të përmbajë prioritetet, objektivat dhe aktivitetet, me anë të cilave synojnë intensifikimin e mëtejshëm të punës së këtij komisioni gjatë vitit të ardhshëm.



## Kryesuesi Ardian Hajdaraj priti në takim Drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë, Altin Dumani

Prishtinë, 24 dhjetor 2024 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, ka pritur në takim drejtuesin e Prokurorisë së Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar të Republikës së Shqipërisë, Altin Dumani, së bashku me bashkëpunëtorë.

Z. Hajdaraj falënderoi z. Dumani për vizitën e tij dhe njëkohësisht e informoi për proceset aktuale të punës dhe sfidat që po e përcjellin Këshillin Prokurorial. “Shpreh gatishmërinë time të lartë dhe të institucionit që përfaqësoj për të forcuar bashkëpunimin e ndërsjellë në fushat përkatëse për sundimin dhe zbatimin e ligjit në të dyja vendet tona”, theksoi me këtë rast z. Hajdaraj.



Nga ana tjetër, Drejtuesi i SPAK-ut, z. Altin Dumani, falënderoi Kryesuesin e KPK-së, z. Ardian Hajdaraj, për pritjen, duke nënvizuar rolin jetik të bashkëpunimit të institucioneve për hetimin dhe ndjekjen e rrjeteve të krimit kombëtar, rajonal dhe më gjerë.

Në përmbyllje të takimit, z. Hajdaraj dhe z. Dumani u pajtuan për të vazhduar intensifikimin e kontakteve dhe vizitave, siç ishte kjo e sotmja e kreut të SPAK-ut, të cilat do të shërbejnë më tej për krijimin e mekanizmave të nevojshëm të partneritetit për luftimin e krimit në Republikën e Kosovës dhe në Republikën e Shqipërisë.



## Dekretohen njëzet e katër prokurorë të rinj

Prishtinë, 27 dhjetor 2024 – Me propozim të Këshillit Prokurorial të Kosovës, Presidentja Vjosa Osmani, ka dekretuar njëzet e katër (24) prokurorë të rinj me mandat fillestar, të cilët në betimin e tyre, theksuan se gjatë kryerjes së detyrave të tyre do të qëndrojnë besnikë ndaj Kushtetutës dhe do të respektojnë rregullat e etikës profesionale.



Pas mbajtjes së kësaj ceremonie betimi, prokurorët e rinj janë pritur në takim nga Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj dhe Ushtruesi i Detyrës së Kryeprokurorit të Shtetit, z. Besim Kelmendi, me ç'rast janë përgëzuar për dekretim e tyre, duke nënvizuar përkushtimin dhe integritetin, paanshmërinë dhe profesionalizmin që duhet t'i kenë gjatë procesit të punës në sistemin prokurorial, duke garantuar zbatimin e ligjit në vendin tonë.



Prokurorët e rinj, të dekretuar sot, janë caktuar nëpër prokuroritë themelore të vendit.



## Mbahet Takimi i 260-të i Këshillit Prokurorial të Kosovës

Prishtinë, 27 dhjetor 2024 – Këshilli i Prokurorial i Kosovës (KPK), i udhëhequr nga Kryesuesi Ardian Hajdaraj, mbajti Takimin e 260-të me radhë, me ç' rast:

1. Miratoi Procesverbali i Takimit të 259-të të Këshillit Prokurorial të Kosovës;
2. Miratoi Raportin tremujor për periudhën korrik-shtator 2024 për aktivitetet dhe rekomandimet e Koordinatorit Kombëtar për Luftimin e Krimit Ekonomik;
3. Miratoi Raportin gjashtëmujor për periudhën janar-qershor 2024 të Komisionit Ad Hoc mbikëqyrës për korrupsion dhe krimet ekonomike;
4. Miratoi Programin e Punës së Komisionit për Vlerësimin e Performancës për vitin 2025;



5. Caktoi prokuroren Fikrije Krasniqi në detyrën e Udhëheqëses së Departamentit për Hetimin e Terrorizmit në Prokurorinë Speciale;
6. Refuzoi ankesat për procesin e emërimit të Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apelit dhe Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Mitrovicë;
7. Zgjodhi prokurorin Agron Bajrami në detyrën e Kryeprokurorit të Prokurorisë së Apeli për një mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat;
8. Zgjodhi prokurorin Arben Kadriu në detyrën e Kryeprokurorit të Prokurorisë në Gjilan për një mandat katërvjeçar;
9. Zgjodhi prokurorin Burim Çerkini në detyrën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Ferizaj për një mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat;
10. Zgjodhi prokuroren Lumturije Vuçetaj në detyrën e Kryeprokurores së Prokurorisë Themelore në Pejë për një mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat;

11. Zgjidhi prokurorin Petrit Kryeziu në detyrën e Kryeprokurorit të Prokurorisë Themelore në Prizren për një mandat katërvjeçar me mundësi rizgjedhjeje edhe për një mandat;

12. Miratoi Raportin përfundimtar të Komisionit për Vlerësimin e Performancës së Prokurorisë për vlerësimin e parë të mandatit fillestar për 21 prokurorë të Grupit VII dhe

13. Miratoi Raport Analitik të Vlerësimit të Performancës së prokurorëve, me mandat të përhershëm, në kuadër të cikli trevjeçar.



## Kryesuesi Hajdaraj mban konferencën e fundvitit për media

Prishtinë, 30 dhjetor 2024 – Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, ka mbajtur konferencën e fundvitit për media, me ç'rast prezantoi të arriturat dhe sfidat e veprimtarisë njëvjeçare.

Z. Hajdaraj, duke falënderuar përfaqësuesit e mediave për bashkëpunimin korrekt dhe të sigurtë përgjatë vitit 2024, theksoi se KPK-ja ka zhvilluar veprimtarinë e saj në disa drejtime, përfshirë hartimin e akteve nënligjore dhe nxjerrjen e 244 vendimeve, të cilat kanë shërbyer për realizimin e mandatit kushtetues dhe ligjor të sistemit prokurorial.



Më këtë rast, Kryesuesi Hajdaraj, tha se KPK-ja realizoi me sukses edhe procesin e zgjedhjes së kryeprokurorëve të Prokurorisë së Apelit dhe prokurorive themelore të vendit, duke bërë emërimin e pesë kryeprokurorëve të prokurorive, si dhe rekrutimin e 24 prokurorëve të shtetit, të cilit u dekretuan nga Presidentja e Republikës së Kosovës.

Po ashtu, z. Ardian Hajdaraj, potencoi se avancimi dhe transferimi i prokurorëve, disiplinimi dhe vlerësimi i performancës së tyre, ishin në mesin e objektivave kryesore që janë zbatuar gjatë këtij viti, si dhe nënvizoi modernizimin dhe përmirësimin e procesit të punës me anë të zhvillimit dhe avancimit të teknologjisë informative, kurse buxheti, tha se është realizuar 96.2%, për të gjitha kategoritë ekonomike dhe programet buxhetore, porse nuk është aprovuar shtimi i numrit të prokurorëve dhe i pozitave për stafin administrativ.

Gjatë kësaj konference, z. Hajdaraj ka trajtuar edhe fuqizimin e transparencës publike, komunikimit proaktiv dhe avancimit të bashkëpunimit me media dhe shoqërinë civile, si dhe ka falënderuar institucionet ndërkombëtare, donatorët dhe partnerët për mbështetjen e madhe që i kanë dhënë avancimit të sistemit prokurorial.

Kryesuesi i Këshillit Prokurorial të Kosovës, z. Ardian Hajdaraj, në përfundim të kësaj konference, prezantoi një mori sfidash kryesore me të cilat është ballafaquar sistemi prokurorial gjatë vitit 2024.

